

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Tirana Turizem” Sh.p.k.

Sot, me date 28.03.2018, ora 10.00, ne Tirane:

Ne Baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin tone te plote dhe te lire, te shprehur me nënshkrimin e ketij akti, ortakët e shoqërisë:

- Z. **Ulrich Salomon Landolt**, lindur në Zurich, Zvicer, më 28 korrik 1967, dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e tij si ortak i shoqërisë “Tirana Turizem” Sh.p.k., i identifikuar nëpërmjet dokumentit pasaporte nr. BC0990333, lëshuar më 13 dhjetor 2017, e vlefshme deri më 12 dhjetor 2027;
- Z. **Lulzim Alushaj**, lindur në Vlore më 08 dhjetor 1977, banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e tij si ortak i shoqërisë “Tirana Turizem” Sh.p.k., i identifikuar nëpërmjet dokumentit kartë identiteti nr. 029951176, lëshuar më 05 tetor 2010, e vlefshme deri më 04 tetor 2020,

hartojnë ketë statut si me poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

Emri i shoqërisë është “Tirana Turizem” Sh.p.k.. Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar, person juridik, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin “Tirana Turizem” Sh.p.k.

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë është ne Rruga “Perlat Rexhepi”, Ndertesa nr. 8, Hyrja nr. 6, Apartamenti nr. 34, Njesia Administrative nr. 5, 1019, Tirane.

M. Landolt

4

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe do të ketë një kohëzgjatje me afat të pacaktuar.

Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka për objekt zhvillimin e aktiviteteve si vijon:

- shërbime të akomodimit turistik;
- krijimi dhe menaxhimi vetë dhe me subjekte të tjera publike dhe private i bareve dhe restoranteve, objekteve rekreative për kohën të lirë, hoteleve dhe menaxhimi i fshatrave turistike dhe plazhe të pajisura;

Shoqëria, për arritjen e objektit të shoqërisë mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale dhe të pasurive të paluajtshme dhe gjithashtu mund të kryejë, çdo aktivitet për publikun, operacionet financiare dhe të letrave me vlerë, të japë garanci, depozita në favor të palëve të treta, dhe të marrë, vetëm për qëllimin e investimeve të qëndrueshme dhe punësimit, si direkt dhe indirekt, pjesëmarrje në shoqëri të huaja me objekt analog ose të lidhur me të.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali i shoqërisë tregtare private "Tirana Turizem" Sh.p.k. do të jetë Leke 100.000 (njëqindmije/00).

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota.

Kuotat janë të ndara si vijon:

- **Z. Ulrich Salomon Landolt** mbajtës i 80 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerën 80.000 (tetedhjetemije/00) Leke;
- **Z. Lulzim Alushaj** mbajtës i 20 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerën 20.000 (njetemije/00) Leke.

Kapitali fillestar i shoqërisë mund të shtohet ose pakësohet dhe është tërësisht i likuidueshem dhe i nenshkrueshem.

- 5.2. Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.
- 5.3. Kuotat e kapitalit mund të derdhen nga ortakët në Banke, në llogarinë bankare të shoqërisë dhe derdhetet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së shoqërisë.
- 5.4. Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë të nënshkruara nga ortakët e shoqërisë.
- 5.5. Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të shoqërisë, në rast se shoqëria nuk regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, brenda 6 (gjashtë) muaj nga data e depozitimit të fondeve.

Neni 6

Transferimi i kuotave me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve si dhe me trashëgimi ndaj ortakeve të shoqërisë, vetëm në rast se rezultojnë se janë respektuar dispozitat e këtij neni.
- 6.2. Në rast transferimi me akt midis të gjallëve të kuotave, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues me parë duhet të bëjë një ofertë, ortakëve të tjerë me leter rekomande, ku përcakton çmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në këtë rast secili nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.
- 6.3. Në rast mosmarrëveshjeje mbi çmimin e kërkuar, ky i fundit do të përcaktohet nga një ekspert kontabël, duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.
- 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi emerimin e ekspertit kontabël, ky i fundit me shpenzimet e secilës pale, do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kerkese të pales së interesuar.
- 6.5. Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe menyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
- 6.6. Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitësi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, perkatesisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të personit që tërhiqet.
- 6.7. E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njerit prej ortakëve i kalon ortakëve të tjerë, gjithmonë në përputhje me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.
- 6.8. Ortaku shitës i kuotave duhet të transferojë këto të fundit me akt notarial ortakëve blerës brenda 3 muajve nga marrja e komunikimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël brenda afatit të 60 ditëve nga dita e vlerësimit.

6.9. E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda nje periudhe tre mujore nga data e komunikimit te ofertes ose brenda 60 diteve nga data e fiksimit te çmimit nga ana e ekspertit kontabël qe eshte emeruar. Pasi kane kaluar afatet e mesiperme, shitesi ka te drejten te transferoje tek te tretet kuotat e tij, me te njëjtat kushte si me siper.

6.10. Transferimi i kuotave per shkak testamenti eshte i kufizuar nga konsensusi i te gjithe ortakeve te mbledhur ne asamblene e përgjithshme.

Neni 7

Fitimet e shoqërisë

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe modalitetet, mbi bazen e përqindjeve te kuotave te nënshkruara.

Neni 8

Parashikime pasurore

Shoqëria tregtare "Tirana Turizem" Sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj te akumuluar. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurisë se vet te akumuluar, tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë, "Tirana Turizem" Sh.p.k. gëzon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 9

Shoqëria "Tirana Turizem" Sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

Neni 10

Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë

Bëjnë pjese ne detyrat dhe kompetencat e ortakeve, te mbledhur ne asamble te përgjithshme, te gjitha ato qe janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe te listuar ne ketë statut. Nder këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi ne aktin e themelimit dhe ne statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, te veprimtarisë se administrimit, te inventarit, te bilancit te llogarisë vjetore;



3. emërimi e shkarkimi i administratoreve ortake e jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qofte për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jete e domosdoshme të jepet shprehimisht një shkak;
4. miratimin e kredive dhe të garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
10. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive të shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e shoqërisë;
12. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë shoqëria, duke autorizuar administratorin e shoqërisë për një veprim të tillë;
13. vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qofte persona fizike qofte juridike;
14. vendimin për ndarjen e kotave dhe për anulimin e tyre;
15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
17. vendimin në shitjet e kuotave të shoqërisë;
18. vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

Per të gjithë periudhën që shoqëria do të jete e kontrolluar nga ortaku i vetëm, vendimet e tij do të regjistrohen në regjistrin e shoqërisë, ashtu si parashikohet në ligj.

Neni 11

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Adresat e-mail të ortakëve regjistrohen pranë një baze të dhenash të dokumentave të shoqërisë.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtate) dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

Neni 12

Kuorumi dhe shumica

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja dhe votimi në asamblesë të përgjithshme, mund të bëhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këtë rast është e nevojshme prezenca e Noterit.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblese së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe duhet t'i nënshtrohen parashikimeve të këtij statuti për sa i përket kuorumit dhe shumicës së kërkuar.

Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamble është pjesëmarrja e ortakëve, ashtu si parashikohet në nenin 86 të Ligjit n. 9901 datë 14.04.2008 "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", që me pas vendosin sipas ligjit.

Neni 13

Administratori

Administrator i shoqërisë emërohet **Z. Ulrich Salomon Landolt**, lindur në Zurich, Zvicër, më 28 korrik 1967, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e tij si ortak i shoqërisë "Tirana Turizem" Sh.p.k., i identifikuar nëpërmjet dokumentit pasaporte nr. BC0990333, lëshuar më 13 dhjetor 2017, e vlefshme deri më 12 dhjetor 2027 që ushtron të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konform ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Ulrich Salomon Landolt 

Administratoret emërohen me nje afat 5 (pese) vjecar duke filluar nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB, me te drejte riemërimi ne qofte se do te emerohet serish administrator nga asambleja e ortakeve. Asambleja e përgjithshme mund te vendose për shkarkimin e tij. Administratori ka te drejte te jape doreheqjen e parakohshme, perpara mbarimit te mandatit, me njoftim, dhenie llogarie dhe aprovim perpara asamblese se përgjithshme, sipas procedurave te parashikuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme mund te emëroje edhe me shume se një administrator, te çfarëdo kombësie dhe te jashtem per shoqerine. Ne rastin e emërimit te një apo me shume administratoreve ne fuqi, secili nga administratoret mund te ushtroje te gjitha tagrat e perfaqesimit dhe te firmes, ne respekt te kompetencave te dhena fillimisht nga asambleja e përgjithshme e ortakeve, te regjistruara prane QKB. Secili nga ato do te jete individualisht përgjegjës per përmbushjen e funksioneve te dhëna nga ligji për administratorin dhe do ti komunikojte te tjerve ose administratorit tjetër veprimet nga ai te kryera.

Neni 14

Detyra dhe funksione të Administratorit

Administratori kryen detyrat e përcaktuara nga ortaket e shoqërisë ne ketë statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te rregulluara me ligj. Nder këto përshihen detyrat e listuara me poshtë.

1. Te veproje dhe te nënshkruaje ne emër te shoqërisë.
2. Te hartojte rregulloren e brendshme te shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar, qe do te miratohet ne asamblenë e përgjithshme.
3. Te marre vendime lidhur me kreditë qe do te merren dhe dhënien e garancive, me aprovimin paraprak te asamblese se përgjithshme.
4. Te përpunoje dhe te paraqesë për miratim ne asamblenë e përgjithshme raporte për ecurinë e aktivitetit te shoqërisë dhe te bilancit te mbylljes se aktivitetit financiar te vitit paraardhës, sipas skadencave qe parashikohen ne ligj.
5. Te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblesë se përgjithshme.
6. Administratori (apo administratoret ne rast se do te emërohet ndonjë tjetër ne vijim) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe te treteve për shkeljet e ligjit apo te normave te statutit qe mund te ndodhin gjate ecurisë se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
7. Te kryeje te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme.
8. Te përfaqësoje shoqërinë tregtare.

9. Te kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
10. Te kryeje regjistrimet dhe te dërgoj te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.
11. Te kryeje detyra te tjera te përcaktuara ne ligj dhe ne statut.
12. Te raportoje përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
13. Pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna
14. Te emeroje financiar e konsulentë për problemet e shoqërisë, me pëlqimin paraprak te asamblese se përgjithshme te ortakeve. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiare te tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer te shoqërisë.
15. Te mire-administroje shoqërinë.
16. Te lidhe marrëveshje me te trete ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te përcaktuara nga ortaket.
17. Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqërisë.
18. Te jete përgjegjës për demet e shkaktuara shoqërisë nga veprimet e tij.
19. Te shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues, mbi bazen e nje kontrate ne forme shkresore.
20. Te informohet dhe te beje propozime për çfarëdolloj gjeje qe e vlerëson si te rëndësishme për shoqërinë.
21. Te kryeje te gjitha veprimet bankare ne lidhje me llogarinë e shoqërisë.
22. Administratorja ka te drejte dhe detyre te thërrasë asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave te përcaktuara ne nenet 12 dhe 13 te këtij statuti dhe te ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht ne statut.

Neni 15

Te drejtat dhe detyrat e shoqërisë

Shoqëria ka te drejte:

1. te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. te siguroje pasurinë e vet;

M. Landa

3. te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase ose te huaja ne baze te rregullave ligjore;
4. te përfitoje nga favoret qe i nje legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera;
5. te investoje kudo ne Shqipëri, me te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj;
6. te punësoje punëtoje, vendas ose te huaj;
7. te eksportoje lirisht valutën qe ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 16

Shoqëria ka për detyre:

1. te siguroje kapitalin e shoqërisë ne formën dhe kohen e duhur;
2. te japë garanci për shërbimet qe kryen shoqëria;
3. te siguroje punonjësit e saj;
4. te plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. te kerkoje dhe vihet ne posedim te lejeve dhe/ose autorizimeve, nqs kërkohen nga ligji, per te ndjekur objektin e shoqërisë.
6. te respektoje standardet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 17

Marrëdhëniet ekonomike – financiare te shoqërisë

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit te veprimtarisë se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik dhe ne pasqyrat financiare te saj.

Neni 18

Ne selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te cilit, brenda datës 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci vjetor i shoqërisë, pas nënshkrimit te administratorit/reve.

Neni 19

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te te njëjtit vit.



Neni 20

Shoqëria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe/ose ne Euro dhe pasqyrohen ne librat kontabël përkatëse te shoqërisë. Per hapjen e pare te llogarise rrjedhëse te shoqerise autorizohen administratoret e shoqerise.

Neni 21

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqëria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te mëparshëm, le mënjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond te arrije masën 10% te kapitalit themeltar.

Neni 22

Dispozita te veçanta

Shoqëria ka vulën e vet dalluese me përmasa te zakonshme, te krijuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe mund te ketë një marke te sajën. Ne rast realizimi te nje siti internet, kjo e dhënë mund te regjistrohet ne mënyrë vullnetare pranë QKB.

Neni 23

Shndërrimi

Shndërrimi i shoqërisë "Tirana Turizem" Sh.p.k. ne shoqëri te tipeve te tjera, mund te behet me vendim te ortakeve themelues sipas modaliteteve te parashikuara me ligj.

Neni 24

Prishja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë, mund te vije për shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe per arsyet si me poshte:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të Art.t 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës;

- humbja e kapitalit te shoqërisë;

Ne këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose me shume likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqëria ndaj personave te trete.

Ne rast se fondet e disponueshem, rezultojnë te pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve te shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkoje ortakëve themelues te shoqërisë qe te derdhe tërësisht kuotat qe i takojnë atij.

Neni 25

Ligji i Aplikueshëm dhe Gjykata Kompetente

Për te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis ortakëve, midis ortakëve dhe shoqërisë dhe midis shoqërisë dhe administratorit, do te jete kompetent juridiksioni i Gjykatave te Republikës se Shqipërisë, dhe do te zbatohet ligji shqiptar.


Neni 26

Ky statut përpilohet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe, te gjitha origjinale te nënshkuara rregullisht nga ortakët

Per regjistrimin, e këtij statuti dhe aktit te themelimit, pranë zyrave te QKB-se, sipas parashikimit te nenit 26 te ligjit n. 9723 date 03.05.2007 "per QKB" autorizohet seicili nga administartoret e shoqerise apo persona nga ata te autorizuar.

ORTAKET E SHOQERISE "Tirana Turizem" Sh.p.k.

Z. Ulrich Salomon Landolt



Z. Lulzim Alushaj

